



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

RREGULLORE

“PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLIN STUDENTOR TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Studentor të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në nivel njësie kryesore dhe institucioni, si dhe kushtet e afatet për regjistrimin e kandidatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, dokumentacionin zgjedhor, listat e zgjedhësve, fushatën zgjedhore, rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës zgjedhore, kriteret për hartimin e listës së zgjedhësve, procedurat për votimin, vlerësimin dhe numërimin e votave, shpalljen e rezultateve, procedurat për shqyrtimin e ankimeve si dhe rregullat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në nenin 99 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 68 të Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Neni 3

Akronime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "UE" është akronim i emrit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani";
2. "KIZS" është akronim i emrit të Komisionit Institucional Zgjedhor Studentor;
3. "KAS" është akronim i emrit të Komisionit të Apelimit Studentor;
4. "KZSF" është akronim i emrit të Komisionit Zgjedhor Studentor të Fakultetit;
5. "KS" është akronim i emrit të Këshillit Studentor;
6. "KSF" është Këshilli Studentor i Fakultetit;
7. "FSHN" është akronim i emrit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës;
8. "FSHH" është akronim i emrit të Fakultetit të Shkencave Humane;
9. "FSHMT" është akronim i emrit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike;
10. "FSHE" është akronim i emrit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit;
11. "FE" është akronim i emrit të Fakultetit Ekonomik.

Neni 4

Subjekti i rregullores

1. Kjo rregullore i shtrin efektet e saj për zgjedhjet për anëtar në KS të UE-së, në nivel njësie kryesore dhe institucioni.
2. Subjekt i kësaj rregulloreje janë studentët që ndjekin studimet me kohë të plotë në UE.
3. Studentët kanë të drejtën të zgjedhin dhe të zgjidhen përfaqësues të studentëve në KS të UE-së, në nivel njësie kryesore dhe institucioni, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në këtë rregullore.

Neni 5

Parimet e përgjithshme

1. Zgjedhjet për Kryetar dhe anëtar të KS-së së UE-së, Kryetar i KSF-së dhe për anëtar të KSF-së, mbahen në mënyrë periodike çdo 2 (dy) vjet.
2. KS-ja e UE-së përbëhet nga 23 anëtarë, ku njëri prej tyre do të jetë kryetar, përkatësisht:
 - a. 4 (katër) përfaqësues nga FSHMT;
 - b. 4 (katër) përfaqësues nga FSHE;
 - c. 4 (katër) përfaqësues nga FSHH;
 - d. 4 (katër) përfaqësues nga FE;
 - e. 4 (katër) përfaqësues nga FSHN;
 - f. 2 senatorët të cilët do të jenë anëtarë këshilli apriori;
 - g. 1 kryetar.
3. Këshilli Studentor i FSHH, UE, përbëhet me përfaqësues të zgjedhur nga çdo program studimi, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë.

4. Këshilli Studentor i FSHN, UE, përbëhet me përfaqësues të zgjedhur nga çdo program studimi, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë.
5. Këshilli Studentor i FSHMT, UE, përbëhet me përfaqësues të zgjedhur nga çdo program studimi, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë.
6. Këshilli Studentor i FSHE, UE, përbëhet me përfaqësues të zgjedhur nga çdo program studimi, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë.
7. Këshilli Studentor i FE, UE, përbëhet me përfaqësues të zgjedhur nga çdo program studimi, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë.
8. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë e të fshehtë, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
9. Çdo votues ka të drejtën e një vote të vetme për secilën strukturë që zgjedh (pra, një votë për Kryetarin e KS-së së UE-së, një votë për Kryetarin e KSF-së dhe një votë për anëtar të KSF-së).
10. Të drejtën për t'u zgjedhur si përfaqësues në KSF-në përkatës (kryetar apo anëtar) e ka çdo student që vetëkandidohet, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
11. Të drejtën për t'u zgjedhur si Kryetar i KS-së së UE-së e ka çdo student që vetëkandidohet, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
12. Çdo kandidat ka të drejtë të organizojë dhe të zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij, duke mos cenuar procesin mësimor.
13. Shpallet i zgjedhur në pozicionin e kryetarit apo anëtarit të KS-së në nivel njësie kryesore dhe institucioni kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme.
14. Kur kemi një kandidat të vetëm duhet të marrë 50%+1 të votave të vlefshme.
15. Çdo kandidat ka të drejtë të ketë vëzhguesin e tij në qendrën e votimit, në qendrën e numërimit të votave, KZSF-në përkatëse, si dhe në KIZS. Listën me emrat e vëzhguesve, kandidati e depoziton pranë KIZS-së 3 (tri) ditë pas aplikimit të tij si kandidat.
16. Për kandidatët që fitojnë numër të barabartë votash, zgjedhja për Kryetar dhe anëtar të KS-së së UE-së, Kryetar të KSF-së dhe anëtar i KSF-së bëhet me short. Shorti organizohet dhe realizohet nga KIZS-ja e UE-së, në prani të kandidatëve.

Neni 6

Periudha zgjedhore dhe thirrja e zgjedhjeve

1. Periudha zgjedhore dhe data e zgjedhjeve, shpallet me urdhër të Rektorit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", duke marrë parasysh afatet e nevojshme për krijimin e komisioneve përkatëse dhe zhvillimin e fushatës zgjedhore.
2. Qendrat e votimit hapen në orën 9:00 dhe mbyllen në orën 15:00. Askush nuk mund të votojë pasi komisionet e qendrave të votimit të fakulteteve të UE-së kanë marrë vendim për mbylljen e votimit, pasi janë siguruar për votimin e të gjithë studentëve që janë në radhë, në pritje të votimit, në orarin e mbylljes së votimit.
3. Zgjedhjet për Kryetar i KS-së së UE-së, Kryetar i KSF-së dhe anëtar i KSF-së zhvillohen brenda së njëjtës ditë.

KREU II

PËRGATITJA DHE ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Neni 7

Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor i Universitetit të Elbasanit

“Aleksandër Xhuvani” (KIZS)

KIZS-ja e UE-së, është organi përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në këtë universitet për Kryetar të KS-së së UE-së, Kryetar të KSF-së dhe anëtar të KSF-së, të cilët zgjedhin të mos kandidojnë për pozicionet e mësipërme.

Neni 8

Përbërja dhe funksionet e KIZS-së

1. KIZS-ja në UE, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh dhe 1 (një) sekretar pa të drejtë vote:

- 1 anëtar nga FSHH;
- 1 anëtar nga FSHN;
- 1 anëtar nga FSHMT;
- 1 anëtar nga FSHE;
- 1 anëtar nga FE.

Kryetar zgjidhet një nga anëtarët.

2. Rektori përzgjedh me short dhe shpall me urdhër anëtarët përfaqësues të KIZS-së dhe 1 (një) përfaqësues për pozicionin e sekretarit jo më vonë se 4 (katër) ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore, nga lista e studentëve të vetëkandiduar, të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.

- a) Në mbledhjen e parë, KIZS-ja zgjedh kryetarin dhe sekretarin me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të saj. Rezultati i zgjedhjes publikohet nga KIZS-ja në të gjitha mjediset e universitetit.
- b) Gjatë periudhës zgjedhore, KIZS-ja mbledhet jo më pak se 3 (tri) herë në javë. Mbledhja thirret nga kryetari ose të paktën nga 2 (dy) anëtarë. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e KIZS-së janë të hapura për çdo kandidat.
- c) KIZS-ja i merr vendimet me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve 50%+1. Vendimet e KIZS-së publikohen në mjediset e UE-së, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë pas vendimmarrjes.

3. KIZS-ja ka këto kompetenca:

- a) nxjerr udhëzime për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor;
- b) drejton dhe kontrollon të gjithë procesin zgjedhor;

c) përzgjedh me short anëtarët dhe sekretarin e KZSF-ve të UE-së, të cilët vetëkandidohen pranë KIZS-së;

d) miraton elementët e vulave për KIZS-në dhe KZSF-të përkatëse, të cilat prodhohen dhe administrohen sipas kuadrit ligjor në fuqi;

g) regjistron kandidatët për kryetar dhe anëtar të këshillave në nivel njësie kryesore dhe institucioni.

h) shpall rezultatin e zgjedhjeve në nivel njësie kryesore dhe institucioni.

i) administron, gjykon dhe merr vendim për ankimimet që regjistrohen prej kandidatëve.

4. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KIZS-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe, për çdo rast, jep shpjegim për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KIZS-së. Vendimet firmosen prej të gjithë anëtarëve të KZS-së. Ditën e votimit, vendimet e marra firmosen dhe vulosen nga KIZS-ja.

5. Mandati i anëtarit të KIZS-së ndërpritet në rastet kur:

- a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
- b) jep dorëheqjen nga detyra;
- c) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- d) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
- e) mungon pa shkaqe të arsyeshme, në 3 (tri) mbledhje radhazi;
- f) humbet statusin e studentit;
- g) ndërron jetë.

6. Vendi i mbetur bosh në KIZS, plotësohet me short nga Rektori brenda 24 (njëzet e katër) orëve prej listave të studentëve të vetëkandiduar, të depozituara në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.

Neni 9

Komisioni Zgjedhor Studentor i Fakultetit (KZSF)

1. Vendimi për ngritjen e KZSF-ve merret nga KIZS-ja jo më vonë se 3 (tri) ditë kalendarike nga dita e formimit të saj.

2. Anëtarët e KZSF-ve nuk kanë të drejtë të kandidojnë për kryetar apo anëtar të këshillave studentor në nivel njësie kryesore dhe institucioni.

3. Anëtarët e KZSF-ve të UE-së zgjidhen me short nga KIZS-ja nga

lista e studentëve të vetëkandiduar për këtë komisione.

4. KZSF-të e UE-së përbëhen nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët në mbledhjen e parë pas konstituimit, zgjedhin mes tyre kryetarin dhe sekretarin me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë (50%+1 votë).
5. KZSF-ja kryen funksionet e Komisionit të Qendrës së Votimit në rastet kur në fakultet ka vetëm një qendër votimi.
6. Sekretari përgatit materialet për çdo mbledhje të KZSF-së. Ai merr pjesë në mbledhje, mban procesverbalet e mbledhjeve dhe, për çdo rast, jep shpjegim për çështjet që i kërkohen. Procesverbali i mbledhjeve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe të firmoset nga sekretari. Sekretari është përgjegjës për administrimin e të gjithë dokumentacionit të KZSF-së. Vendimet firmosen prej të gjithë anëtarëve të KZSF-së. Ditën e votimit, vendimet e marra firmosen dhe vulosen nga KZSF-ja me vulën e marrë nga KIZS-ja bashkë me materialet zgjedhore.
7. KZSF-të i marrin vendimet me shumicë të thjeshtë (50%+1) të të gjithë anëtarëve të tyre.
8. KZSF-të kanë këto kompetenca:
 - a) përgjigjen për administrimin dhe zhvillimin e procedurave të votimit për trupën zgjedhore të fakultetit përkatës;
 - b) pas përfundimit të procesit të votimit, fillojnë procesin e numërimit të votave, rezultatin e të cilave e pasqyrojnë në procesverbalet dhe tabelat përkatëse;
 - c) hartojnë tabelën përfundimtare të rezultateve të votimit të KZSF-ve përkatëse dhe shpallin me vendim të veçantë, rezultatet e votimeve për Kryetarin e KS-së së UE-së, Kryetarin e KSF-së, anëtarët e KSF-së;
 - d) i përcjellin brenda 24 (njëzet e katër) orëve rezultatin e dalë nga procesi zgjedhor KIZS-së.
9. Mandati i anëtarit të KZSF-së ndërpritet në rastet kur:
 - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
 - b) jep dorëheqjen nga detyra;
 - c) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
 - d) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 (tri) mbledhje radhazi;
 - e) humbet statusin e studentit;
 - f) ndërron jetë.
10. Vendi i mbetur bosh në KZSF plotësohet me short nga KIZS-ja brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga lista e kandidatëve që janë vetëkandiduar në sekretarinë e komisionit.

Neni 10

Komisioni i Apelimit Studentor (KAS)

1. KAS-i përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh të cilët vetëkandidohen, 1 (një) anëtar për secilin fakultet, të cilët zgjedhin mes tyre kryetarin. Anëtarët e KAS-it nuk kanë të drejtë të kandidojnë për Kryetar të KS-së, Kryetar të KSF-së dhe anëtar të KSF-së.

2. Rektori përzgjedh me short dhe shpall me urdhër anëtarin përfaqësues të KAS-it jo më vonë se 4 (katër) ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore, nga lista e studentëve të vetëkandiduar, të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.
3. Në mbledhjen e parë, KAS-i zgjedh në mesin e tyre kryetarin dhe sekretarin, me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1) të anëtarëve të tij. Rezultati i zgjedhjes publikohet nga KAS-i në mjediset e UE-së.
4. Gjatë periudhës zgjedhore, KAS-i mbledhet vetëm për të marrë në shqyrtim kërkesat e drejtuara nga kandidatët. Mbledhjet e KAS-it janë të hapura për çdo kandidat dhe çdo anëtar të KIZS-së në UE.
5. KAS-i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij (50%+1). Vendimet e KAS-it publikohen në mjediset e universitetit, jo më vonë se 24 orë pas vendimmarrjes.
6. KAS-i ka këto kompetenca:
 - a) shqyrton dhe merr vendim të arsyetuar, në të cilin përfshihen edhe mendimet “kundër”, për çdo ankim për vendime të marra prej KIZS-së;
 - b) administron, gjykon dhe merr vendim për ankimimet që regjistrohen prej kandidatëve;
 - c) dërgon për dijeni të KIZS-së vendimet e marra për ankesat që janë paraqitur pranë tij.
7. Vendimi i KAS-it është i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyrueshëm për t’u zbatuar.
8. Mandati i anëtarit të KAS-it ndërpritet në rastet kur:
 - a) kryen veprimtari në favor të një kandidati;
 - b) jep dorëheqjen nga detyra;
 - c) dënohet për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) me veprimet dhe mosveprimet e tij cenon rëndë veprimtarinë e komisionit dhe procesin zgjedhor;
 - e) mungon, pa shkaqe të arsyeshme, në 3 (tri) mbledhje radhazi;
 - f) humbet statusin e studentit;
 - g) ndërron jetë.
9. Vendi i mbetur bosh në KAS plotësohet nga Rektori me short, brenda 24 orëve, prej listave të studentëve të vetëkandiduar, të depozituara në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.

Neni 11

Qendra e votimit

- 1) Votimi kryhet në qendrat e votimit, konkretisht në:
 - a. 1 qendër votimi në FSHN;
 - b. 1 qendër votimi në FSHE;
 - c. 1 qendër votimi në FSHH;
 - d. 1 qendër votimi në FE;
 - e. 1 qendër votimi në FSHMT.

Në të gjitha qendrat e votimit të mësipërme votohet për Kryetar të KS-së së UE-së; Kryetar të KSF-së; anëtar të KSF-së.

KREU III

ZGJEDHËSIT DHE LISTA E ZGJEDHËSVE

Neni 12

Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve

1. Kanë të drejtën e zgjedhjes të gjithë studentët e UE-së.
2. Kanë të drejtën për të kandiduar të gjithë studentët e UE-së.
3. Struktura përgjegjës për hartimin e listës së zgjedhësve është sekretaria mësimore e fakultetit përkatës, duke ndarë më vete listat sipas secilit program studimi.
4. Procedurat për hartimin e listës së zgjedhësve është si më poshtë:
 - a- Lista paraprake e studentëve hartohet nga sekretaria mësimore jo më vonë se 3 (tri) ditë nga shpallja e ditës së zgjedhjeve;
 - b- Lista paraprake afishohet në mjediset e fakulteteve përkatëse;
 - c- Gjatë një periudhe deri në 3 (tre) ditë pas shpalljes së listës paraprake, sekretaria mësimore pranon kërkesa për korrigjime;
 - d- Pas verifikimit të kërkesës, sekretaria mësimore realizon korrigjimin e kërkuar brenda 24 (njëzet e katër) orësh;
 - e- Pas përfundimit të afatit për korrigjimin e listës, sekretaria mësimore harton listën përfundimtare, e cila miratohet nga dekani i fakultetit përkatës.
5. Lista e zgjedhësve afishohet në mjediset e fakultetit përkatës dhe një kopje e listës i dërgohet KIZS-së. Lista e miratuar duhet të jetë e firmosur në çdo faqe nga dekani dhe e vulosur me vulën e fakultetit përkatës.

KREU IV

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE PËR KRYETAR TË KËSHILLIT STUDENTOR DHE FUSHATA ZGJEDHORE

Neni 13

Regjistrimi i kandidatëve

1. Procesi i regjistrimit të kandidatëve për Kryetar të KS-së së UE-së; Kryetar të KSF-së; anëtarë të KSF-së, bëhet nga KIZS-ja. Data për fillimin e procedurës për regjistrimin e kandidatëve shpallet nga KIZS-ja pas ditës së konstituimit të tij dhe zgjat 7 (shtatë) ditë kalendarike.
3. Dokumentet e kandidimit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Neni 14

Dokumentacioni për kandidim

1. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët për Kryetar të KS-së së UE-së; Kryetar të KSF-së dhe anëtar të KSF-së dorëzohet në KIZS dhe përmban:
 - a- Kërkesën për kandidim e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe një deklaratë të shprehjes së vullnetit për kandidim për kryetar dhe anëtar të këshillave në nivel njësie kryesore dhe institucioni;
 - b- Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
 - c- Vërtetim që provon se është student me kohë të plotë pranë fakultetit përkatës;
 - d- kandidati për Kryetar të KS në nivel njësie kryesore dhe institucioni duhet të depozitojë një listë të nënshkruar nga 30 (tridhjetë) studentë;

Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZS-ja, jo me vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listat e kandidatëve për kryetar dhe anëtar të këshillave në nivel njësie kryesore dhe institucioni, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Listat e kandidatëve për kryetar dhe anëtar të këshillave në nivel njësie kryesore dhe institucioni shpallen publikisht në mjediset e universitetit.

Neni 15

Kohëzgjatja e mandateve

Kryetari dhe anëtarët e KS-së së UE-së, Kryetari i KSF-së dhe anëtarët e KSF-së zgjidhen për një mandat 2-vjeçar.

Neni 16

Fushata zgjedhore

1. Fushata zgjedhore fillon një ditë pas shpalljes së kandidatëve të regjistruar.
2. Fushata zgjedhore përfundon 24 (njëzet e katër) orë para ditës së zgjedhjeve. Dita para datës së zgjedhjeve dhe data e zgjedhjeve deri në mbylljen e votimit formojnë periudhën e heshtjes zgjedhore. Në periudhën e heshtjes zgjedhore nuk lejohet asnjë fushatë zgjedhore.
3. Administratori dhe administrata e UE-së, krijojnë kushtet e përshtatshme dhe të barabarta për të gjithë kandidatët për të zhvilluar aktivitetin e tyre në kuadër të fushatës elektorale. Në përputhje me kërkesën e kandidatit për kohën dhe vendin për zhvillimin e aktivitetit, administrata e UE-së, merr të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e tij, pa cenuar

procesin mësimor, si dhe përcakton mjediset dhe plotëson kërkesat e komisioneve të ngritura në fakultetin përkatës, me qëllim zhvillimin e zgjedhjeve.

4. Fushata zgjedhore zgjat 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së kandidaturave për Kryetar të KS-së, Kryetar të KSF-së dhe anëtar të KSF-së.

KREU V

PËRGATITJA E INFRASTRUKTURËS DHE DOKUMENTACIONIT PËR ZGJEDHJE

Neni 17

Vendndodhja e komisioneve zgjedhore dhe vendeve të numërimit të votave

1. Vendndodhja e komisioneve zgjedhore përcaktohet sipas rregullit të mëposhtëm:
 - a. Zyrat e KIZS-së dhe KAS-it vendosen në godinën e Rektoratit të UE-së;
 - b. Zyrat e KZSF-ve vendosen në godinat e fakulteteve përkatëse të UE-së, të cilat shërbejnë edhe si qendra e votimit dhe numërimit të votave.

Neni 18

Komisionet për vlerësimin dhe numërimin e votave

1. Votat vlerësohen dhe numërohen prej KZSF-ve përkatëse.
2. KZSF- të përkatëse të UE-së, pas numërimit të votave, plotësojnë tabelën zgjedhore dhe ia përcjellin atë KIZS-së.
3. KIZS- ja shpall rezultatin e zgjedhjeve sipas përcaktimeve në këtë rregullore dhe pas kalimit të afateve për ankimimin, shpall fituesin e zgjedhjeve.

Neni 19

Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor

1. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve sipas listave, plus 1% e tyre.
2. Për zgjedhjen e Kryetarit të KS-së së UE-së, Kryetarit të KSF-së dhe anëtarëve të KSF-së studentët do të votojnë me 3 (tri) fletë me ngjyra të ndryshme.
3. Forma e fletës së votimit përgatitet nga KIZS-ja.
4. Fletët duhet të jenë letër format A4.
5. Fletët e votimit përmbajnë informacionet e mëposhtme:

- a. Në to vendosen emrat e kandidatëve për kryetar dhe anëtar për këshillat studentor në nivel njësie kryesore dhe institucioni;
- b. Të gjitha fletët e votimit vulosen me vulën e KIZS-së përpara se të dërgohen në KZSF-të e fakulteteve.

Neni 20

Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KIZS-ja në KZSF

1. KIZS-ja dërgon në KZSF kutinë e materialeve zgjedhore, si më poshtë vijon:
 - a. Fletët e votimit të vulosura me vulën e KIZS-së në përputhje me numrin e votuesve (+1%);
 - b. Listën e zgjedhësve;
 - c. Vulat e KZSF-ve përkatëse;
 - d. Procesverbalet e qendrës së votimit, ku do të bëjnë pjesë procesverbalet për vulosjen e kutive të votimit, hapjen e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, si dhe mbylljen e votimit;
 - e. Zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të dëmtuara";
 - f. Zarfin në të cilin është shënuar "Fletëvotimi të papërdorura";
 - g. Zarfin në të cilin është shënuar "Zarf i procesverbalit të vulosjes".
2. Përveç kutisë me materiale zgjedhore, në KZSF dërgohen edhe kutitë e votimit, tabelat për rezultatin e zgjedhjeve, dhomat e fshehta dhe vulat me kodet e sigurisë.
3. KIZS-ja shpërndan bazën materiale të nevojshme për zhvillimin e votimit në KZSF-në ngritur në fakultetin përkatës. Ky proces bëhet ditën e zgjedhjeve, përpara fillimit të procesit të votimit, dhe pasqyrohet në procesverbalin përkatës.

KREU VI

VOTIMI

Neni 21

Veprimet paraprake për hapjen e qendrës së votimit

1. Në çdo qendër votimi votohet në tri kuti votimi, kutia e votimit për Kryetar të KS të UE-së, për Kryetar të KSF dhe për anëtar të KSF.
2. KZSF-të, nën drejtimin e kryetarit, një orë përpara hapjes së qendrës së votimit kryejnë këto detyra:
 - a. Vendosin tryeza, karrige, dhoma të fshehta dhe kutitë e votimit, në mënyrë të tillë që të sigurohet fshehtësia e votimit, si dhe lëvizja e shpejtë dhe e lirshme e zgjedhësve;

- b. Afishojnë udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të përshtatshëm dhe të dukshëm brenda qendrës së votimit;
 - c. Kontrollonjë të gjitha materialet e marra në dorëzim;
 - d. U tregojnë të pranishmëve kutitë e votimit të zbrazëta;
 - e. Mbyllin kutitë e votimit dhe i shkruajnë këto kode në procesverbalin e vulosjes së kutive të votimit dhe në librin e protokollit të mbledhjeve, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KZSF-së.
3. Procesverbali mbyllet në zarfin ku është shkruar "Zarfi i procesverbalit të vulosjes ", i cili futet në kutinë e votimit. Anëtarët e KZSF-ve marrin vendimin për hapjen e votimit dhe e nënshkruajnë atë.

Neni 22

Procedura e votimit

1. Votimi për Kryetar të KS-së së UE-së, Kryetar të KSF-së dhe anëtar të KSF-së bëhet në të njëjtën ditë në të gjitha fakultetet e UE-së, në datën e përcaktuar nga Rektori. Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, kryetari i KZSF-së deklaron hapjen e votimit, por jo më vonë se ora 09:00.
2. Fletët e votimit janë të vulosura në pjesën e pasme, në vendin e caktuar, me vulën e KIZS-së. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtari të komisionit. Pasi zgjedhësi hyn në qendrën e votimit:
 - a. thotë emrin e tij dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identifikimit:
 - letërnjoftim ID;
 - pasaportë;
 - b. kryetari, pasi verifikon se të dhënat e identitetit të zgjedhësit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe pasi zgjedhësi është i njëjtë me personin në dokumentin e identitetit, shënon në listën e zgjedhësve llojin dhe numrin e serisë së dokumentit të identitetit dhe i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë;
 - c. nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij;
 - d. kryetari vulos fletën e votimit me vulën e KZSF-së dhe ia jep zgjedhësit;
 - e. pasi merr fletën e votimit, hyn në dhomën e fshehtë dhe në krah të emrit të kandidatit shënon;
 - f. pasi bën shënimin në fletën e votimit, palos fletën në mënyrë që shenja të mos jetë e dukshme, del nga dhoma e fshehtë, e hedh fletën në kutinë përkatëse të votimit dhe largohet nga qendra e votimit.
3. Qendra e votimit organizohet në një mënyrë të tillë që të lehtësojë procesin e votimit dhe të garantojë plotësisht fshehtësinë e votës.

4. Në qendrën e votimit është i ndaluar përdorimi i mjeteve të komunikimit apo regjistrimi nga ana e votuesit.
5. Në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm:
 - a. anëtarët e KZSF-së dhe vëzhguesit e miratuar nga KIZS- ja për llogari të kandidatëve;
 - b. zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit, deri në përfundim të tyre.

Neni 23

Mbyllja e votimit

1. Qendrat e votimit mbyllen në orën 15:00. Nëse edhe pas kalimit të këtij orari ka zgjedhës që presin në radhë, komisioni mbledh dokumentet e identifikimit e të gjithë zgjedhësve të pranishëm dhe i thërret ata me radhë për të kryer votimin.
2. Asnjë zgjedhës tjetër nuk do të lejohet të votojë nëse nuk ka qenë në radhë në kohën e mbledhjes së dokumenteve të identifikimit. Pasi voton edhe zgjedhësi i fundit i pranishëm, komisioni merr vendim për mbylljen e votimit, duke plotësuar formularin përkatës, ku shënohet edhe ora e mbylljes së votimit. Pas kësaj, në qendrën e votimit mund të qëndrojnë vetëm anëtarët e komisionit.

Neni 24

Veprimet pas mbylljes së qendrës së votimit

1. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e votimit, kryetari, në praninë e anëtarëve të komisionit kryen, sipas radhës, veprimet e mëposhtme:
 - a. shënon numrin e zgjedhësve që kanë votuar, duke numëruar nënshkrimet e bëra në listën përkatëse të zgjedhësve, të cilët kanë votuar sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore;
 - b. iu deklaron shifrat me zë të lartë anëtarëve të tjerë të komisionit;
 - c. i fton ata të verifikojnë shifrat e thëna prej tij.
2. Në rast kundërshtimesh për përcaktimin e shifrës, pretendimet shënohen në procesverbal.
3. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, i numëron fletët e votimit të dëmtuara që gjenden në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" për secilën kategori. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
4. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit numëron dhe fletët e papërdorura dhe i vendos ato në zarfin përkatës. Numri i fletëve të votimit të papërdorura pasqyrohet në procesverbalin për "Mbylljen e votimit".
5. Procesi vijues i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e KS-së së UE-së, Kryetar të KSF-së dhe anëtar të KSF-së kryhet nga KZSF-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin.
6. Kryetari i KZSF-së, bashkë me anëtarët e tjerë të komisionit, dorëzojnë në KIZS kutitë e votimit bashkë me materialet zgjedhore të qendrës së votimit.

Neni 25

Vlerësimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit për zgjedhjet e këshillit studentorë të fakulteteve të UE-së

1. Procesi i vlerësimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet e Këshillit Studentor kryhet nga KZSF-të përkatëse dhe vazhdon pa ndërprerje deri në nxjerrjen e rezultatit përfundimtar për fakultetin përkatës.
2. Kryetari i KZSF-së nxjerr nga kutia e votimit fletët e votimit, i shpalos dhe i vendos mbi tryezë, me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Pas kësaj ai:
 - a. vlerëson të gjitha votat e gjetura në kuti, duke ia treguar të gjithë anëtarëve të KZSF-së. Votat e pavlefshme ndahen në një grup të veçantë;
 - b. numërohen votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Numri i tyre, së bashku me numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti shënohen në procesverbal;
 - c. verifikon numrin e përgjithshëm të votave të gjetura në kuti me numrin e votave që duhet të gjenden në kuti, në bazë të të dhënave të procesverbalit të hartuar më parë nga KZSF-ja, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, për numrin e përgjithshëm të fletëve të votimit, fletëve të votimit të papërdorura dhe fletëve të votimit të dëmtuara. Rezultati shënohet në procesverbal;
 - d. harton tabelën përfundimtare për kutinë përkatëse dhe e miraton me vendim.
3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:
 - a. fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KZSF-ja;
 - b. fletës së votimit i mungon vula;
 - c. në fletët e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;
 - d. në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose disfavor të studentit kandidat;
 - e. është votuar në tejkalim të përcaktimeve në fletën e votimit;
 - f. nuk është votuar për asnjë kandidat.
4. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, KZSF-ja harton tabelën përfundimtare të rezultatit të votimit sipas numrit të votave.
5. Tabela përfundimtare dhe vendimi përkatës i KZSF-së, si edhe të gjitha procesverbalet e tjera nënshkruhen nga të gjithë anëtarët dhe kryetari, duke deklaruar votën "pro"ose "kundër".
6. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të votimit u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.
7. Çdo kontestim apo vërejtje e kandidatëve shënohen detyrimisht në procesverbal nga sekretari i KZSF-së.

8. Në përfundim të procesit të vlerësimit dhe numërimit të votave, në prani të KZSF-së dhe/ose kandidatëve të pranishëm:

- a. futen dhe administrohen në kutitë e votimit të numëruara të vlefshme dhe të pavlefshme;
- b. futen dhe administrohen në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi "Fletëvotimi të përdorura";
- c. futen dhe administrohen në kutinë e materialeve zgjedhore zarfi "Fletëvotimi të dëmtuara";
- d. futen dhe administrohen në kutinë e materialeve zgjedhore procesverbalin për numrin e fletëve të votimit gjithsej, numrin e fletëve të përdorura dhe numrin e fletëve të dëmtuara, si edhe tabela përfundimtare e rezultatit të votimit për KZSF-në përkatëse.

9. Kryetari i KZSF-së mbyll kutitë e votimit dhe shënon në procesverbalin elementet e sigurisë (kodet) për mbylljen e këtyre kutive.

10. Dorëzimi i materialeve zgjedhore dhe i kutive të votimit në KIZS bëhet nga kryetari i KZSF-së me procesverbal, në prani të anëtarëve të KZSF-së përkatëse dhe /ose kandidatëve, menjëherë pas përfundimit të proceseve të përshkruara në këtë rregullore.

Neni 26

Shpallja e rezultatit paraprak të zgjedhjeve për KS-në e UE-së

1. Pas përfundimit të vlerësimit dhe numërimit të votave, nxjerrjes së rezultatit të votimit nga të gjitha KZSF-të dhe dërgimit të tyre në KIZS, ky i fundit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, harton tabelën e rezultateve të votimit dhe shpall, me vendim të veçantë, rezultatin e zgjedhjeve për anëtarët dhe kryetarët e këshillave studentor në nivel të njëjësive kryesore dhe të institucionit.
2. Tabela e rezultateve zgjedhore dhe vendimi i KIZS-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët.
3. Kopje e tabelës përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve u jepet, sipas kërkesës, kandidatëve.

Neni 27

Ankimimet

1. Kundër vendimeve të KZSF-së për shpalljen e tabelave përfundimtare të rezultatit të zgjedhjeve, ankimimi bëhet nga kandidatët në KIZS, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e shpalljes së tyre. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendarike. KIZS-ja administron dhe merr vendime për ankimimet jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë pas paraqitjes së tyre.

2. Kundër vendimeve të KIZS-së për ankesat e kandidatëve për rezultatin e zgjedhjeve, apelimi i vendimit bëhet nga kandidatët në KAS, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit. Për efekt të llogaritjes së afatit, periudha 2-ditore fillon në orën 16:00 të ditës së shpalljes së aktit për të cilin bëhet ankimimi dhe përfundon në orën 16:00, pas 2 (dy) ditëve kalendarike.
3. Me përfundimin e procesit të shqyrtimit të ankimimeve të dërguara nga KAS-i, KIZS-ja shpall, me vendim të veçantë, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Neni 28

Konstituimit i KS-së dhe KSF-ve të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

1. Pas përfundimit të afateve të apelimit KIZS-ja me vendimin shpall fituesin për pozicionin e Kryetarit të KS-së së UE-së, Kryetarët e KSF-ve dhe anëtarëve të KSF-ve.
2. KIZS-ja brenda 5 (pesë) ditëve, emëron Kryetaret e KSF-ve të shpallur fitues.
3. Kryetarët e zgjedhur të KSF-ve brenda 5 (pesë) ditëve nga emërimi thërrasin KSF-në. Pas konstituimit të KSF-ve me votë të fshehtë zgjidhen 4 (katër) anëtarët që do të përfaqësojnë Fakultetin në KS-në e UE-së.
4. KIZS-ja brenda 10 (dhjetë) ditëve nga konstituimit i KSF-ve thërret KS-në e UE-së dhe organizohet mbledhja e parë e KS. Në këtë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët dhe Kryetari i KS-së së UE-së, të shpallur fitues nga zgjedhjet e zhvilluara.

Neni 29

Pavlefshmëria e zgjedhjeve

1. KIZS-ja, kryesisht ose me kërkesë të kandidatëve, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një ose më shumë qendra votimi, në rast se:
 - a) kanë ndodhur shkelje të ligjit;
 - b) mund të jetë cenuar procesi zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në fitimin e mandateve;
 - c) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim.
2. Kërkesën për pavlefshmëri të zgjedhjeve, kërkuesi, duhet ta shoqërojë me shpjegimin për arsyet ligjore ku mbështetet kërkesa, përshkrimin e shkeljeve të pretenduara dhe arsyetimin e detajuar të tyre për pasojat që kanë prodhuar. Shqyrtimi i kërkesës për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe vendimmarrja për kërkesën bëhet nga KIZS-ja, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga depozitimi i saj.

Neni 30
Dispozitat e fundit

1. I gjithë dokumentacioni zgjedhor ruhet në arkivin e KS-së së UE-së, në bazë të rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit.
2. Në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit ose anëtarëve të KS-së së UE-së apo kryetarit ose anëtarëve të KSF-ve, ata zëvendësohen nga kandidatët pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhje, deri në përfundim të mandatit të nisur.
3. Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka KIZS-ja, e cili mund të ofrojë mbështetje përgjatë gjithë procesit zgjedhor.
4. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar si e tillë nga të gjitha strukturat studentore të UE-së dhe hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar me Vendim të Senatit Akademik nr. 54 datë 26.11.2018

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr. Skënder Topi